



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1155/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Arben Kastratit kandidat për asamble komunale në Vushtrri nga rradhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër komisionarëve të vendvotimit 2717b pas publikimit të rezultateve perfundimtare për kuvend komunal nga KQZ-a për shkak të mungesave të votave për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Arben Kastratit nga rradhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Vushtrri kandidat për kuvendin komunal të Vushtrrise.

Arsyetim

PZAP-i , më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Arben Kastrati kandidat për asamble komunale në Vushtrri nga rradhët e AAK-së me dyshimin për numërimin e gabuar dhe manipulimin me votat e tij në qendrën e votimit 2717b. Parashtruesi i ankesës kërkon nga organet kompetente që të bëjnë rinumërimin e votave në këtë qendër të votimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e Arben Kastratit për shkak të mosnumërimit dhe manipulimit me votat e tij, PZAP-i konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka

bashkangjitur asnjë provë për tu vërtetuar pretendimet e tilla ankimore dhe se me këtë rast për asnjë moment nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 1155/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.